Bashkia Kamez
PROTOKOLLI
Nr. 4830 Data 10.6.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
LAGJIA ADMINISTRATIVE NR.2

Nr 588 Prot

Kamëz, më 04.06.2024

**RELACION**

**"Mbi emertimin e rrugeve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Kamëz"**

Të nderuar këshilltarë,

Duke shprehur mirënjohjen për detyrat tuaja funksionale që realizoni pranë këshillit Bashkiak Kamëz, ju paraqesim relacionin mbi emertimin e rrugëve në Lagjen Administrative Nr.2, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 9270 datë 29.07.2004 "Për sisemin e adresave "; Vendimit nr.226 prot 27.03.2023 për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz si dhe referuar kërkesave me shkrim të banorëve të depozituara pranë Lagjes administrative Nr.2 për emertimin e këtyre rrugeve.

Në Bazë të verifikimeve në terren nga grupi punës rezulton që firmat korespondojnë konkretisht me kërkesat e parashtruara nga komuniteti i këtyre lagjeve dhe ju propozojmë ju në cilësinë e organit legjislativ të bashkisë Kamëz, marrjen e tyre në shqyrtim, emertimin e rrugës të cituar si më poshtë:

**-Rruga pa emër ngjitur ngjitur me territorin e UBT-së në pjesën veriore të mbajë emrin''Dr.Lucë Agraja". I ndjeri Dr.Lucë Agraja ka patur gradë shkencore "Doktor"të fituar në Universitet Gjermane .Duke konsideruar vlerat e tij akademike, shkencore dhe shoqërore që përfaqëson kjo figure është propozuar që të vendoset ky emër.**

Komisioni i posaçëm ka shqyrtuar dokumentacionin e qytetarëve që kanë dërguar kërkesën me shkrim për vendosjen e emrit të rrugës dhe janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore me qellim realizimin e kërkesës së qytetarëve.

Për sa më lartë :

**PROPOZOJMË**

Miratimin e kërkesave të qytetarëve për ndryshimin e emertimit të rrugës , me arsyetimin se nga verifikimet e Komisionit të Posaçëm të grupit të punës rezulton që firmat korespondojnë konkretisht me kërkesat e parashtuara nga komuniteti i këtyre lagjeve dhe kërkesat e tyre përmbushin kriteret ë parashikimeve ligjore në fuqi.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj,

**Komisioni i Posaçëm:**

-Agim Koçeku *Firma* ____

-Mehmet Abdullaj *Firma* ____

-Viktor Leci *Firma* ____

**ADMINISTRATOR**

**Blerta MATRAKU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - LAGJJA NR. 2 - BASHKIA KAMËZ

shkiaKamëz Bulevardi "DONALD J. TRUMP", Nr. 21 Kamëz, e-mail: lagjia2@kamza.gov.al .

**KËRKESË**

**Lënda:** Për emërtimin e rrugës ngjitur me territorin e Universitetit Bujqësor të Tiranës, në pjesën veriore, "Rruga Dr. Lucë Agraja"

**Drejtuar:** Këshillit Bashkiak të Bashkisë Kamëz

Kryetarit: Z. Rakip SULI

...mez
...LLI
6375 29.8.23

I nderuar Z. Kryetar,

Të nderuar antëarë të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Kamëz,

Jemi një grup profesorësh nga Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT), që po Ju drejtohemi nepermjet kësaj kerëkese, me anë të së cilës kërkojmë emërtimin e rrugës ngjitur me territorin e UBT-s, specifikisht në pjesën veriore "Rruga Dr. Lucë Agraja".

Konstatojmë që Bashkia Kamëz, sidomos përgjatë këtyre viteve të fundit, i ka kushtuar vëmendje vlerësimit të figurave të rëndësishme të të gjitha fushave, që kanë kontribuar për bashkinë dhe qytetarët e saj, apo edhe ata që kanë kontribuar për shoqërinë në tërësi. Ky vlerësim i këtyre figurave vjen në forma të ndryshme, ku një nga të cilat është edhe emërtimi i rrugëve të Bashkisë me emrin e këtyre personaliteteve.

Duke vlerësuar këtë qasje të Bashkisë Kamëz nje grup profesorësh të UBT-s, mendojnë të propozojnë emërtimin e një rrugë me emrin e një kolegu tonë të shkëlqyer, i cili është ndarë nga jeta në moshë të re.

Dr. Lucë Agraja lindi në Dajç, Shkodër, më 30.12.1972 në një familje të ardhur nga zona e Dukagjinit. Shkollimin parauniversitar e ka kryer në vendlindjen e tij Dajç. Filloi studimet e larta në Institutin e Lartë Bujqësor (sot Universiteti Bujqësor i Tiranës) në vitin 1991 dhe i përfundoi ato në vitin 1996.

Në maj të vitit 1997 Lucë Agraja filloi punë në UBT, si pedagog i ri në Departamentin e Ekonomisë Agrare dhe Zhvillimit Rural. Në vitin 1998 shkon për studime pasuniversitare në Qendrën Ndërkombëtare të Studimeve Agronomike Mesdhetare të Avancuara CHANIA, Kretë/Greqi, studime të cilat i përfundoi në vitin 2001 duke marrë gradën "Master i Shkencave".

Në Tetor të vitit 2002 Lucë Agraja fito një bursë studimi "Doktoraturë" në Universitetin e Hohenheim Stuttgart/Germany. Kolegu ynë Lucë Agraja i përfundoi studimet e doktoraturës në

shtator të vitit 2006, me vlerësimin shkëlqyer. Studimi i tij, në kuadër të doktoraturës, ka patur në fokus "Vlerësimin e avantazheve konkuruese të prodhimit të grurit në Shqipëri". Me këtë studim Dr. Lucë Agraja ka qënë një nga të parët, që aplikoi një metodologji vlerësimi tërësisht të re në hapësirën akademikë shqiptare. Për këtë arsye kontributi i tij, për kërkime të mëtejshme në fushën e bujqësisë nëpërmjet aplikimit të metodologjisë së avantazheve konkuruese, përbën një nga kontributet më të vyera të punës dhe jetës së tij akademike.

Pas përfundit të studimeve të doktoraturës Z. Agraja u kthye në Shqipëri, për të dhënë kontributin e tij në edukimin e brezave të rinjë, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës me përkushtim dhe devotshmëri. Gjatë kësaj periudhe Dr. Lucë Agraja ka qënë i vetmi koleg në UBT, që ka patur gradë shkencore "Doktor" të fituar në Universitetet Gjermane.

Ai vazhdoi të edukonte brezat e rinj me dijet më bashkekohore në modulin e Menaxhimit të Projekteve në fushëm e bujqësisë deri në ditën që u nda nga jeta, më 7 Gusht të vitit 2009.

Ne, kolegët, shokët dhe miqtë e tij duke konsideruar vlerat akademike, shkencore dhe shoqërore që përfaqëson figura e Lucë Agrajës, kërkojmë ta përjetësojmë emrin e tij duke kërkuar nga Ju, anëtarë të nderuar të Këshillit, emërtimin e një rruge me emrin e tij.

Kërkesës sonë i bashkohen me dëshire edhe një grup banorësh të lagjes ku kalon rruga në fjalë.

Mbetemi shpresëplotë në një vendim pozitiv nga ana JUAJ!

Profesorët dhe kolegët e Dr. Lucë Agraja!

Banorët!

Bashkia Kamez
PROTOKOLLI
Nr 4472 Data 30.5.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
LAGJE ADMINISTRATIVE BATHORE

Nr679Prot

Bathore, me 28.05.2024

**RELACION**

**"Mbi emertimin e rrugeve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Kamëz"**

Të nderuar këshilltarë,

Duke shprehur mirënjohjen për dëtyrat tuaja funksionale që realizoni pranë këshillit Bashkiak Kamëz, ju paraqesim relacionin mbi ndryshimin e emertimit të rrugëve në Lagjen Administrative Bathore, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 9270 datë 29.07.2004 "Për sisemin e adresave "; Vendimit nr.226 prot 27.03.2023 për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz si dhe referuar kërkesave me shkrim të banorëve te lagjeve të ndryshme Bathore, të depozituara pranë Lagjes administrative Bathore për emertimin e këtyre e rrugeve.

Në Bazë të verifikimeve në terren nga grupi punes rezulton që firmat korespondojnë konkretisht me kërkesat e parashtruara nga komuniteti i këtyre lagjeve dhe ju propozojmë ju në cilësinë e organit legjislativ të bashkisë Kamëz, marrjen e tyre në shqyrtim për ndryshimin e emertimit të rrugëve të cituara si më poshtë:

- Ndryshimi i emertimit të rrugës nga emri ekzistues "Ujimisht" në emertimin "Fishti". **Në këte rruge jetojne 16 familje të fisit Fishti me origjine nga Dibra, të cilët gëzojnë rrespekt kundrejt njëri-tjetrit dhe gjithashtu janë qytetare të përgjegjshëm në komunitet.**

Komisioni i posaçëm ka shqyrtuar dokumentacionin e qytetarëve që kanë dërguar kërkesat me shkrim për ndryshimin e emertimit të rrugeve dhe janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore me qellim realizimin e kërkesës së qytetareve

Për sa më lartë :

**PROPOZOJMË**

Miratimin e kërkesave të qytetarëve për ndryshimin e emertimit të rrugëve , me arsyetimin se nga verifikimet e Komisionit të Posaçëm të grupit të punës rezulton që firmat korespondojnë konkretisht me kërkesat e parashtuara nga komuniteti i këtyre lagjeve dhe kërkesat e tyre përmbushin kriteret ë parashikimeve ligjore në fuqi.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj,

**Komisioni i Posaçëm:**

-Besim Rama *Firma* ____________

-Qemal Meçuku *Firma* ____________

-Selman Billa *Firma* ____________

**ADMINISTRATOR**

**Afrim DOÇI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA KAMEZ - LAGJA BATHORE

Rep. Shqipërisë
Bashkia Kamëz
Nj. adm. Bathore

Këshillit bashkiak
Kamëz

Kerkesë

Për ndryshimin e emrit te rrugës që sot quhet "Ujmisht" te emrohet "rruga Fishti"

Arsya: Eshte dëshirë e banoreve te rrugës pasi shumica jane me mbiemrin "Fishti"

| Nr. | Emer Atesi Mbiemer | |
|---|---|---|
| 1. | Lavdrim Gani fishti | [signature] |
| 2. | Khelil Lavdrim Fishti | [signature] |
| 3 | Ferruk Fariz Fishti | [signature] |
| 4 | Kreshnik Ferruk fishti | [signature] |
| 5 | Isak Fariz fishti | [signature] |
| 6 | Deli Gani fishti | [signature] |
| 7 | Afrim Gani fishti | [signature] |
| 8 | Taulant Afrim fishti | [signature] |
| 9 | Fitim Gani fishti | [signature] |
| 10 | Sefki Petrit Fishti | [signature] |
| 11 | Ervin Petrit fishti | [signature] |
| 12 | Gezim Gani fishti | [signature] |
| 13 | Leulzim Miftar fishti | [signature] |
| 14 | Vullnet Miftar Fishti | [signature] |
| 15 | Elez Isuf Fishti | [signature] |
| 16 | Isuf Elez fishti | [signature] |
| 17 | MEKI KALESHI | [signature] |
| 18 | Shaban Koleshi | [signature] |
| 19 | Bashkim Neli | [signature] |
| 20 | Det Troci | [signature] |
| 21 | Lavdrim Bushkjo | [signature] |

Bashkia Kamez
PROTOKOLLI
Nr. 1086 Dt. 06.02.24

Dat 5-11-2024 Mbetemi me shpres se Kerkesa jonë do meret parasysh nga Bashkia

Bashkia Kamez
PROTOKOLLI
Nr. 4613 Date 4.6.24

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KAMËZ**
**NJËSIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN**

**Nr. 1151 prot.** **Paskuqan, më 29.05.2024**

**RELACION**

**"Mbi emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Kamëz"**

Të nderuar këshilltarë,

Duke shprehur mirënjohjen për detyrat tuaja funksionale që realizoni pranë Këshillit Bashkiak Kamëz, ju paraqesim relacionin mbi ndryshimin e emërtimit të rrugëve në Njësinë Administrative Paskuqan, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 9270, date 29.07.2004 "Për sistemin e adresave"; Vendimit nr. 226 prot., date 27.03.2023 "Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz"; si dhe referuar kërkesave me shkrim të banorëve të lagjeve të ndryshme në Paskuqan, të depozituara pranë Njësisë Administrative Paskuqan për emërtim rruge të lagjeve të tyre.

Në bazë te verifikimeve në terren nga grupi i punës rezulton që firmat korrespondojne konkretisht me kërkesat e parashtruara nga komuniteti i këtyre lagjeve dhe ju propozojme ju në cilësinë e organit legjislativ të Bashkisë Kamëz, marrjen e tyre në shqyrtim për ndryshimin e emërtimit të rrugës të cituar si më poshtë:

- Segmenti rrugor i paemërtuar që ndodhet në rrugën "Konferenca e Mukjes" kërkohet të emërtohet në rrugën "Fejzulla Sadik Rrapi";

  *z. Fejzulla Rrapi ka dhënë një kontribut shumë të vyer duke dhuruar truallin e tij për të ndërtuar shkollën 9-vjeçare "Dom Nikoll Kaçorri", të cilin këtë truall e kishte të trashëguar brez pas brezi nga familja e tij. Z. Fejzulla Rrapi ka ndërruar jetë në moshën 73 vjeçare më date 13.09.2019. Me mirënjohjen më të madhe për z. Fejzulla, banorët kërkojnë nga Bashkia Kamëz ta shpallin atë qytetar nderi dhe në nder të tij të vendoset emri i tij në një rrugë.*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KAMËZ**
**NJËSIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN**

Komisioni i posaçëm ka shqyrtuar dokumentacionin e qytetarëve që kanë dërguar kërkesat me shkrim për ndryshimin e emërtimit të rrugëve dhe janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore me qëllim realizimin e kërkesës së qytetarëve.

Për sa më lartë:

**PROPOZOJMË**

Miratimin e kërkesave të qytetarëve për ndryshimin e emërtimit të rrugëve, me arsyetimin se nga verifikimet e Komisionit të Posaçëm të grupit të punës rezulton që firmat korenspondojne konkretisht me kerkesat e parashtruara nga komuniteti i këtyre lagjeve dhe kërkesat e tyre përmbushin kriteret konform parashikimeve ligjore në fuqi.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj,

Komisioni i posaçëm:

-Idriz Imeraj *Firma*: ______

-Çaush Kullafi *Firma*: ______

-Sami Doda *Firma*: ______

**A D M I N I S T R A T O R**
**Sefedin AHMATI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - NJËSIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN - BASHKIA KAMËZ

Adresa: Babrru-Paskuqan, Rruga "Demokracia" E-mail: adm.paskuqan@kamza.gov.al

BASHKIA KAMËZ
PROTOKOLLI
Nr 767 DT 11.04.2024

Dt. 09/04/2024

Drejtuar : Bashkia Kamëz

**Kërkesë**

Keshillit bashkiak kamez

Fejzulla Sadik Rrapi u lind me datë 20/07/1946 në fshatin Babrru të Tiranës.Familja e tij përbëhej nga 7 fëmijë, 6 djem dhe një vajzë.Familja e fejzullaut ishte nga familjet e para që krijuan fshatin e Babrrusë. Ato ishin një familje autoktone dhe patriotike. Gjatë luftës anifashiste nacional çlirimtare ata u angazhuan fuqishëm duke kontribuar në çlirimin e vendit. Me ardhjen e demokracisë shumë familje u shpërngulen nga vendbanimet e tyre duke emigruar por familja e Fejzulla Rrapit nuk lëvizi nga Babrruja vëndi ku u lindën eu rritën dhe u arsimuan nipat e mbesat e tij.Duke qenë një familje arsimdashëse në vitin 2010 Z.Fejzulla Rrapi do të jepte një kontribut të vyer duke dhuruar truallin e shkollës 9-vjeçare Dom Nikoll Kaçorri ,truall që e kishte të trashëguar brez pas brezi nga famija e tij. E ndaj këtij kontributi të paçmuar banorët e Babrrusë i janë falenderues Z. Fejzulla Sadik Rrapi i cili ndërrojë jetë me dt 13.09.2019 në moshën shtatëdhjetë e tre vjeçare .Për këtë arsye i drejtohen Bashkisë Kamëz ta shpalli atë Qytetar Nderi si dhe në nder të tij ti vendoset një rruge emri i tij. Vijojme me poshte me emrat e kryefamiljareve te zones

ROLANDO RRAPI
H70413103 N
[signature]

Shpetim Rrapi
[signature]
H71218059 M

Franc Rrapi
[signature]


Rruga Konferenca e Mukjes
Rruga Konferenca e Mukjes